

VENDIM
Nr. 163, datë 12.7.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË
LICENCUARIT OSE NDRYSHIMIN E ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON
INTERESAT E TË LICENCUARIT”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “g”, si dhe nenit 51, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.7.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/1 prot., datë 30.6.2021, të përgatitur nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 45, datë 15.6.2021, të kryetarit të ERE-s, për hartimin e draftrregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit”,

konstatoi se:

- Në kushtet e licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe në sektorin e gazit natyror:

- është përcaktuar se nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence;

- rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit” ka për qëllim të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për të licencuarit në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike ose të gazit natyror, që paraqesin kërkesën, për:

- ndryshimin e statusit ligjor;

- ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

- hipotekimin, barrësimin, lënien peng barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të të tretët të kuotave apo aksioneve, kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakut/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar;

- rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit” trajton çështjet në lidhje me autoritetin, qëllimin, fushën e zbatimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e kërkesës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, shqyrtimin e aplikimit, vendimmarrjen e Bordit, njoftimin e vendimit dhe përmbajtjen e regjistrimit të autorizimeve të dhëna nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit”.

2. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti